



Projekti i financuar nga Agjencia Universitare e Frankofonisë

me titull:

“Zhvillimi dhe gërshetimi i qasjeve të reja pedagogjike dhe teknologjike në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhëve të huaja në sistemin parauniversitar në shqipëri, si një zgjidhje për periudhën post Covid-19”

Koordinator: Prof. Asoc. Dr. Ogerta Koruti

Faza e parë: Hartimi, zhvillimi dhe shpërndarja e pyetësorit

Gjatë periudhës 25.05.2022 - 09.06.2022 janë realizuar të 3 aktivitetet e fazës së parë të projektit.

Aktiviteti 1 - Hartimi i pyetësorit

Për realizimin e këtij aktiviteti, u ftua trajnerja Aleksandra Kasmj, e cila foli për këto çështje:

- Kuptimi i pyetësorit në kërkimin shkencor;
- Rëndësia e përdorimit të pyetësorit në kërkimin shkencor;
- Teknikat e hartimit të pyetësorit në kërkimin shkencor;
- Teknikat e zhvillimit të pyetësorit në kërkimin shkencor;
- Avantazhet e përdorimit të pyetësorit në kërkimin shkencor;
- Përpilimi i pyetësorëve online.

Rezultatet e marra

Gjatë të tre ditëve grupi i punës dhe studentët pjesëmarrës u trajnuan mbi llojet e pyetësorëve dhe se si mund të përdoren në situata të ndryshme shkencore për të mbledhur të dhëna sasiore dhe/ose cilësore, si të përpilojnë një pyetësor, llojet e pyetjeve që mund të përdoren dhe si mund të ndërtojmë pyetësorë me anë të aplikacioneve që janë online.



Aktiviteti 2 – Shpërndarja e pyetësorit

Pyetësi i ndërtuar në platformën Office – Forms u shpërnda elektronikisht nëpërmjet adresave të emailit të mësuesve të sistemit parauniversitar, mundësuar nga DPAP.



Aktiviteti 3 – Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Per realizimin e aktivitetit 3 ne përpunimin dhe analizën e të dhënave, trajnerja Aleksandra Kasmi ndihmoi grupin e punës përgjegjës për përpunimin e të dhënave të mbledhura nga pyetësorët e shpërndara tek mësuesit e gjuhëve të huaja, që japin mësim në sistemin parauniversitar.

Rezultatet e marra

- Pyetësi u realizua me një numër të madh mësuesish të gjuhëve të huaja (500) në të gjithë Shqipërinë;
- Hartimi i një raporti për problemet e hasura gjatë krizës Covid-19;
- Pjesëmarrësit u trajnuan dhe u aftësuan mbi mënyrat e hartimit të pyetësorëve të ndryshëm dhe në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.
- Analiza e nevojave shërbeu si bazë për hartimin dhe zbatimin e një plani trajnimi që synon futjen dhe zhvillimin e qasjeve të reja pedagogjike dhe teknologjike në mësimdhënien/nxënien e gjuhëve të huaja në sistemin parauniversitar si një zgjidhje për krizën post Covid.